VENDIM
Nr.148, datë 22.10.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR "TV KABLLOR STAR"

Në mbështetje nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor "Tv kabllor Star", në fushën e transmetimeve të televizionit me kabllo.

2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 21.10.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati